

Monitorimi i Respektimit të Ligjit për Kontrollin e Duhanit në Kosovë

Pirja e duhanit në vendet publike

Kosovo Advocacy and Development Centre

Tetor 2014

UCK No. 48/3 1
10000 Prishtinë, Kosovë
info@kadc-ks.org
ëëë.kadc-ks.org
+377 44 188 366

Falënderim

KADC falënderon organizatat jo qeveritare për mbështetjen në realizimin e monitorimit të zbatimit Ligjit për Kontrollin e Duhanit në shtatë komunat kryesore të Kosovës:

“CBM” Mitrovicë, “Merita” Gjilan, “IFK” Gjakovë, “Syri i Vizionit” Pejë, “INPO” Ferizaj, “Ec Ma Ndryshe” Prizren, grupin e të rinjve “Mos e Dhez” Prishtinë.

Përmbajtja

Falënderim	2
Përmbajtja	3
Përmbledhje	4
Hyrje	6
Metodologjia	6
Rezultatet e monitorimit	7
Monitorimi në nivel të vendit.....	7
Respektimi i Ligjit për Kontrollin e Duhanit.....	7
Ndarja e hapësirave të brendshme në kundërshtim me ligjin	8
Shpuzoret në hapësirat e brendshme	8
Mjetet tjera si zëvendësim i shpuzoreve për pirje të duhanit	9
Shenjat për ndalimin e pirjes së duhanit.....	10
Pyetja: A lejohet pirja e duhanit?	11
Monitorimi sipas kohës së vizitave.....	12
Respektimi i Ligjit në kohë të ndryshme gjatë ditës.....	12
Pyetja: A lejohet pirja e duhanit?	13
Monitorimi sipas komunave	14
Pirja e duhanit në institucionet publike sipas komunave.....	14
Pirja e duhanit në sektorin e gastronomisë dhe vendet tjera publike sipas komunave	14
Përfundimi	15
Hapat e ardhshëm	16

Përmbledhje

Në maj të vitit 2013 në Kosovë ka hyrë në fuqi Ligji për Kontrollin e Duhanit i cili ndalon 100% pirjen e duhanit në hapësira të mbyllura në vende publike me qëllim të mbrojtjes së shëndetit publik të gjeneratave të tanishme dhe të ardhshme nga pasojat shkatërruese shëndetësore, sociale, ekonomike dhe mjedisore të konsumimit të duhanit dhe ekspozimit ndaj tymit të duhanit.

Nëpërmjet këtij monitorimi synohet matja e nivelit të respektimit të Ligjit për Kontrollin e Duhanit gjegjësisht zbatimit të ndalimit të pirjes së duhanit në vende publike. Gjithashtu ky monitorim ka për qëllim që autoriteteve zbatuese të ligjit t'u ofrojë të dhëna empirike mbi shkallën e zbatueshmërisë dhe respektimit të ligjit, të cilat atyre do tu shërbejnë që të përcaktojnë prioritetet dhe të adoptojnë politikat e nevojshme për një zbatim efikas të Ligjit për Kontrollin e Duhanit.

Gjatë muajit tetor 2014, prej 13 deri me 23 tetor, KADC ka monitoruar nivelin e respektimit të Ligjit për Kontrollin e Duhanit përkatësisht pirjen e duhanit në vende publike dhe vende të punës në shtatë qytetet më të mëdha të Kosovës: Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj dhe Gjiilan. Në këtë proces janë angazhuar 20 monitorues të cilët kanë kryer gjithsej 648 observime. Prej tyre 154 observime janë bërë në institucionet publike dhe 494 observime në sektorin e gastronomisë dhe objekte private.

Objekt i monitorimit kanë qenë institucionet shëndetësore, institucionet arsimore (shkollat e mesme, kolegjet/universitetet), objektet komunale, gjykatat, sektori i mikpritjes (restorantet, kafenetë, baret/klubet e natës, hotelet), qendrat tregtare, qendrat e fitnesit dhe objektet private. Restorantet dhe kafenetë janë monitoruar në kohë të ndryshme prej 8:00-16:00, 16:00-20:00 dhe pas orës 20:00; ndërkaq baret/klubet e natës janë monitoruar pas orës 22:00.

Sipas gjetjeve të monitorimit, niveli i shkeljes së Ligjit për Kontrollin e Duhanit gjegjësisht niveli i pirjes së duhanit në vende publike ku është e ndaluar me ligj në Kosovë pasqyrohet si në vijim: *institucionet shëndetësore 7.7%, universitete/kolegje 8.8%, shkolla të mesme 16.2%, gjykata 20%, objektet komunale 22.2%, qendra tregtare 3.6%, hotele 14.3%, restorante 29.3%, kafene 60.4%, klube nate 82.6%, objekte private 27.9% dhe qendra fitnesi 50%.*

Rezultatet e monitorimit tregojnë se shkeljet e ligjit gjegjësisht ndalimit të pirjes së duhanit në sektorin e gastronomisë deri në ora 16:00 janë 21.7%. Ato shpeshohen nga ora 16:00 deri në ora 20:00 në 38.2%, dhe shënojnë pikun pas orës 20:00 duke arritur në 59.7%. Ndër arsyet kryesore të rritjes së shkeljeve të Ligjit për Kontrollin e Duhanit në sektorin e gastronomisë në orët e vona të pasdites dhe orët e mbrëmjes është bindja e krijuar tek personat përgjegjës për hapësirën se vizitat inspektuese nga ana e inspektorëve pas orarit zyrtar të punës nuk ndodhin fare apo janë shumë të rralla.

Në pyetjen provokuese se a mund të tymosi duhan në këtë hapësirë, pjesa dërmuese e institucioneve publike janë përgjigjur me jo, me disa përjashtime në objektet komunale dhe në shkolla të mesme.

Në po të njëjtën pyetje në sektorin e gastronomisë dhe vendet tjera publike, shkeljet më të mëdha janë vërejtur nga baret/klubet e natës dhe kafene të cilët janë përgjigjur me 47,8% gjegjësisht 28,1% se mund të tymoset duke dhënë si përgjigje më të shpeshta: mund të tymosni në përgjegjësinë tuaj, mund të tymosni në tavolina të caktuara etj.

Me qëllim të përmirësimit të respektimit të Ligjit për Kontrollin e Duhanit dhe bazuar në gjetjet e dala nga monitorimi është e nevojshme që të intensifikohen vizitat inspektuese në sektorin e gastronomisë, sidomos në klube nate, restorante dhe kafene por edhe në institucionet publike ku janë vërejtur shkeljet e ligjit, si në universitete, kolegje, shkolla të mesme dhe objekte komunale.

Gjithashtu është e nevojshme që në sektorin e gastronomisë të shpeshtohen vizitat inspektuese në orët mbrëmjes kur edhe është vërejtur se ndodhë numri më i madh i shkeljeve.

Gjatë monitorimit është vërejtur se vendosja e shenjave zyrtare për ndalimin e pirjes së duhanit - të cilat mungojnë në shumë institucione dhe vende tjera publike - është e domosdoshme për të siguruar një zbatim efikas të Ligjit për Kontrollin e Duhanit.

Hyrje

Në maj të vitit 2013 në Kosovë ka hyrë në fuqi Ligji për Kontrollin e Duhanit i cili ndalon 100% pirjen e duhanit në hapësira të mbyllura në vende publike me qëllim të mbrojtjes së shëndetit publik të gjeneratave të tanishme dhe të ardhshme nga pasojat shkatërruese shëndetësore, sociale, ekonomike dhe mjedisore të konsumimit të duhanit dhe ekspozimit ndaj tymit të duhanit.

Nëpërmjet këtij monitorimi synohet matja e nivelit të respektimit të Ligjit për Kontrollin e Duhanit gjegjësisht zbatimit të ndalimit të pirjes së duhanit në vende publike. Gjithashtu ky monitorim ka për qëllim që autoriteteve zbatuese të ligjit t'u ofrojë të dhëna empirike mbi shkallën e zbatueshmërisë dhe respektimit të ligjit, të cilat atyre do tu shërbejnë që të përcaktojnë prioritetet dhe të adoptojnë politikat e nevojshme për një zbatim efikas të Ligjit Për Kontrollin e Duhanit.

Metodologjia

Gjatë muajit tetor 2014, prej 13 deri me 23 tetor, KADC ka monitoruar nivelin e respektimit të Ligjit për Kontrollin e Duhanit përkatësisht pirjen e duhanit në vende publike dhe vende të punës në shtatë qytetet më të mëdha të Kosovës: Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj dhe Gjilan. Në këtë proces janë angazhuar 20 monitorues të cilët kanë kryer gjithsej 648 observime. Prej tyre 154 observime janë bërë në institucionet publike dhe 494 observime në sektorin e gastronomisë dhe objekte private.

Objekt i monitorimit kanë qenë institucionet shëndetësore, institucionet arsimore (shkollat e mesme, kolegjet/universitetet), objektet komunale, gjykatat, sektori i mikpritjes (restorantet, kafenetë, baret/klubet e natës, hotelet), qendrat tregtare, qendrat e fitnesit dhe objektet private. Restorantet dhe kafenetë janë monitoruar në kohë të ndryshme prej 8:00-16:00, 16:00-20:00 dhe pas orës 20:00; ndërsa baret/klubet e natës janë monitoruar pas orës 22:00.

Përveç pirjes së duhanit në hapësirat ku është e ndaluar me ligj, monitoruesit kanë observuar gjithashtu edhe vendosjen e shenjave për ndalimin e pirjes së duhanit, praninë e shpuzoreve apo mjeteve tjera që janë përdorur si zëvendësim i shpuzoreve, si dhe praninë hapësirave të veçanta dedikuara për pirjen së duhanit të ndara në kundërshtim me ligjin.

Gjatë kësaj periudhe monitoruesit kanë shpërndarë edhe broshurat informative për zbatimin e ligjit si dhe shenjat zyrtare për ndalimin e pirjes së duhanit në vende publike.


Në fund të çdo vizite personat përgjegjës për hapësirën janë pyetur nga monitoruesit se a mund të tymosin duhan në atë hapësirë për te vlerësuar në këtë mënyrë nivelin e gatishmërisë së personave përgjegjës për të përmbushur përgjegjësitë e tyre ligjore.

Rezultatet e monitorimit


Monitorimi në nivel të vendit

Respektimi i Ligjit për Kontrollin e Duhanit

Niveli i shkeljes së ligjit në shkallë të vendit në institucionet publike është treguar të jetë më i ulëti në **institucionet shëndetësore me 7.7%**, në universitete/kolegje 8.8%, në shkolla të mesme 16.2%, në gjykata 20% , ndërsa shkeljet më të shpeshta janë observuar në **objektet komunale me 22.2%**.




Niveli i shkeljes së ligjit në sektorin e gastronomisë është më i larti në **klube nate/bare me 82.6%**, ndërsa respektohet më së shumti në **qendrat tregtare me gjithsej 3.6% raste të shkeljeve**. Në objektet tjera të cilat ofrojnë shërbime mikpritëse është si vijon: në hotele 14.3%, në restorante 29.3%, në kafene 60.4%, në objekte private 27.9% dhe qendra fitnesi me 50%.




Ndarja e hapësirave të brendshme në kundërshtim me ligjin

Në institucionet publike ndarje të hapësirës së brendshme për pirje të duhanit janë vërejtur në institucionet shëndetësore 3.8%, **shkolla të mesme 27.0%**, dhe objekte komunale 13.9%. Nuk janë vërejtur ndarje të hapësirës së brendshme në universitete/kolegje dhe gjykata.




Ndërkaq në sektorin e gastronomisë dhe vendet tjera publike ndarje të hapësirës së brendshme për pirje të duhanit janë vërejtur në **restorante 8.7%**, kafene 5.1%, qendra tregtare 3.6% dhe bare apo klube nate 4.3%. Nuk janë vërejtur ndarje të hapësirës së brendshme në hotele, qendra të fitnesit dhe objekte private.




Shpuzoret në hapësirat e brendshme

Në institucionet publike shpuzoret e vendosura në tavolina në hapësirat e brendshme janë vërejtur më së shumti në **objektet komunale 11.1%** dhe në shkolla të mesme 8.1%.




Në sektorin e gastronomisë dhe vendet tjera publike prania e shpuzoreve të vendosura në hapësirat e brendshme është vërejtur më së shumti në **klube nate 43.5%**, restorante 14.7%, kafene 26.8%, objekte private 16.3% dhe më së paku në qendra tregtare 3.6%.




Mjetet tjera si zëvendësim i shpuzoreve për pirje të duhanit

Si zëvendësim i shpuzoreve më së shpeshti është hasur të përdoren, tavla të filxhanëve të kafesë, shishet e plastikës etj. Prania e tyre më e shpeshtë është hasur në **bare/klube nate me 43.5%**. Nuk janë vërejtur në hotele dhe universitete/kolegje.




Shenjat për ndalimin e pirjes së duhanit


Në vendosjen e shenjave për ndalimin e pirjes së duhanit sa i përket institucioneve publike prijnë **institucionet shëndetësore 80.8% dhe gjykatat me 80%** përderisa më së paku ka në objektet komunale- 25%.



Ndërkaq në sektorin e gastronomisë dhe vendet tjera publike, shenjat për ndalimin e pirjes së duhanit më së shumti janë të vendosura në **hotele 57.1% dhe restorante 49%**.




Janë vendosur edhe shenja tjera për ndalimin e pirjes së duhanit.




Pyetja: A lejohet pirja e duhanit?

Në pyetjen provokuese se a mund të tymosi duhan në këtë hapësirë, pjesa dërmuese e institucioneve publike janë përgjigjur me jo, me disa përjashtime në objektet komunale dhe në shkolla të mesme.




Për të njëjtën pyetje në sektorin e gastronomisë dhe vendet tjera publike, shkeljet më të mëdha janë vërejtur nga baret/klubet e natës dhe kafenetë të cilët janë përgjigjur me 47, 8% gjegjësisht 28,1 % se mund të tymoset duke dhënë si përgjigje më të shpeshta - mund të tymosni në përgjigjësini tuaj, mund të tymosni në tavolina të caktuara etj.



Monitorimi sipas kohës së vizitave

Respektimi i Ligjit në kohë të ndryshme gjatë ditës

Respektimi i Ligjit për Kontrollin e Duhanit në kohë të ndryshme të ditës është i ndryshëm. Rezultatet e monitorimit tregojnë se shkeljet e ligjit gjegjësisht ndalimit të pirjes së duhanit në sektorin e gastronomisë deri në **ora 16:00 janë 21.7%**. Ato shpeshohen nga ora **16:00 deri në ora 20:00 në 38.2%**, dhe shënojnë pikun **pas orës 20:00 duke arritur në 59.7%**. Ndër arsyet kryesore të rritjes së shkeljeve të Ligjit për Kontrollin e Duhanit në sektorin e gastronomisë në orët e vona të pasdites dhe orët e mbrëmjes është bindja e krijuar tek personat përgjegjës për hapësirën se vizitat inspektuese nga ana e inspektorëve pas orarit zyrtar të punës nuk ndodhin fare apo janë shumë të rralla.



Personat përgjegjës për hapësirën veprojnë ndryshe në kohë të ndryshme të ditës edhe në rastin e vendosjes së shpuzoreve të cilat janë të ndaluara me ligj.



E njëjta dukuri si në rastin e shpuzoreve vërehet edhe në rastin e vendosjes së mjeteve të tjera që përdoren në vend të shpuzoreve. Edhe këtu në orët e pasdites së vonshme (22,9%) dhe në orët e mbrëmjes (35,2%) vërehet një prani më e lartë e mjeteve që përdoren si zëvendësim i shpuzoreve.


Vendosja e mjeteve tjera që përdoren në vend të shpuzoreve në hapësirën e brendshme sipas kohës



Pyetja: A lejohet pirja e duhanit?

Në pyetjen e monitoruesve se a lejohet pirja e duhanit, përgjigjet janë të ndryshme në kohë të ndryshme. Më poshtë lehtë vërehet se si përgjigja **nuk lejohet (75.3%) prej orës 8:00-16:00** bie në **57.3% pas orës 16:00** apo në **37% pas orës 20:00**. Ndërkaq përgjigja se mund të tymosni në përgjegjësin tuaj nga **13.7% ngjitet në 23.7% pas orës 16:00**, dhe në **27.3% pas orës 20:00**.


Pyetja: A lejohet pirja e duhanit? - sipas kohës



Monitorimi sipas komunave


Pirja e duhanit në institucionet publike sipas komunave

Zbatimi i ligjit për kontrollin e duhanit ndryshon nëpër komuna. Gjilani prinë për nga shkeljet e ligjit në institucionet publike, ato komunale dhe gjykata.



Pirja e duhanit në sektorin e gastronomisë dhe vendet tjera publike sipas komunave

Në të gjitha komunat shkeljet më të mëdha të ligjit janë në sektorin e gastronomisë.



Përfundimi

Niveli i respektimit të Ligjit për Kontrollin e Duhanit në shkallë të vendit në institucionet publike rezulton të jetë më i larti në institucionet shëndetësore dhe më i ulëti në objektet komunale. Në sektorin e gastronomisë ky ligj gjegjësisht ndalimi i pirjes së duhanit respektohet më së shumti në qendrat tregtare e më së paku në klube nate.

Respektimi i ligjit ndryshon edhe sipas kohës. Niveli i shkeljes së ndalimit të pirjes së duhanit në sektorin e gastronomisë rritet pas orës 16:00 kur përfundon orari zyrtar i punës së inspektorëve, dhe shënon pikun pas orës 20:00. Ndër arsyt kryesore të rritjes së shkeljeve të Ligjit për Kontrollin e Duhanit në sektorin e gastronomisë në orët e vona të pasdites dhe orët e mbrëmjes është bindja e krijuar tek personat përgjegjës për hapësirën se vizitat inspektuese nga ana e inspektorëve pas orarit zyrtar të punës nuk ndodhin fare apo janë shumë të rralla.

Ndarjet e hapësirës së brendshme për pirje të duhanit në kundërshtim me ligjin në institucionet publike janë vërejtur më së shumti në shkolla të mesme dhe objekte komunale. Ndërkaq në sektorin e gastronomisë dhe vendet tjera publike më së shumti hapësira dedikuar tymosjes së duhanit vërehen në restorante. Nuk janë vërejtur ndarje të hapësirës së brendshme në hotele, qendra të fitnesit, objekte private, në universitete/kolegje dhe gjykata.

Në institucionet publike shpuzoret e vendosura në tavolina në hapësirat e brendshme janë vërejtur më së shumti në objektet komunale dhe në shkolla të mesme përderisa në sektorin e gastronomisë dhe vendet tjera publike janë vërejtur më së shumti në klube nate dhe më së paku në qendra tregtare. Në hapësirat e brendshme si zëvendësim për shpuzore poashtu janë vërejtur mjete të tjera si shishe të plastikës, tavlla të kafesë, etj.

Në vendosjen e shenjave për ndalimin e pirjes së duhanit prijnë institucionet shëndetësore dhe gjykatat, përderisa më së paku ka në objektet komunale. Në sektorin e gastronomisë dhe në vendet tjera publike më së shumti janë të vendosura në hotele dhe restorante.

Pjesa dërmuese e institucioneve publike nuk luhaten në pyetjen se a mund të pihet duhan në hapësirën e brendshme. Sidoqoftë, lëshime ka pasur në objektet komunale dhe në shkolla të mesme. Në vendet tjera publike ka pasur më shumë lëshime në bare/klube nate dhe kafene duke dhënë si përgjigje më të shpeshta: mund të pini në përgjegjësinë tuaj, pirja lejohet në tavolina të caktuara, etj.

Hapat e ardhshëm

Me qëllim të përmirësimit të respektimit të Ligjit për Kontrollin e Duhanit dhe bazuar në gjetjet e dalta nga monitorimi është e nevojshme që të intensifikohen vizitat inspektuese në sektorin e gastronomisë, sidomos në klube nate, restorante dhe kafene; por edhe në institucionet publike ku janë vërejtur shkeljet e ligjit si në universitete, kolegje, shkolla të mesme dhe objekte komunale.

Gjithashtu është e nevojshme që në sektorin e gastronomisë të shpeshtohen vizitat inspektuese në orët mbrëmjes kur edhe është vërejtur se ndodhë numri më i madh i shkeljeve.

Gjatë monitorimit është vërejtur se vendosja e shenjave zyrtare për ndalimin e pirjes së duhanit - të cilat mungojnë në shumë institucione dhe vende tjera publike - është e domosdoshme për të siguruar një zbatim efikas të Ligjit për Kontrollin e Duhanit.